



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2 Shkurt 2022

Nr: 37

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË KRISTIAN DEMOKRATE PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE
PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13 438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së Zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 02, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 mars 2022”. të ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës së depozituar nga Partia Kristian Demokrate, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj”, 93, 115 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të nenit 61, pika 4, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, me Dekretin nr. 13 438, datë 20.01.2022, ka caktuar datën 6 Mars 2022, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për Bashkinë Shkodër, Bashkinë Dibër, Bashkinë Durrës, Bashkinë Vorë, Bashkinë Rrogozhinë dhe Bashkinë Lushnjë.



Partia Kristian Demokrate, me shkronja nistore “PKD”, nëpërmjet Kryetarit të saj, z. Dhimitër Muslia, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, administruar me nr. 287 prot., datë 28.01.2022.

Kërkesa e paraqitur nga Partia Kristian Demokrate, respekton afatin kohor, të parashikuar në pikën 7, të vendimit nr. 02, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 mars 2022”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i paraqitur nga Partia Kristian Demokrate, për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, përbëhet si më poshtë:

- Vërtetimi lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 27.01.2022, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia Kristian Demokrate, me iniciale “PKD”, me Kryetar z. Dhimitër Muslia, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë;
- emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresa e partisë;
- specimeni i vulës së partisë;
- emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë (z. Nik Necaj);
- emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në (zj. Olta Çibuku);
- deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale, si dhe përkushtimin për të konkurruar në zgjedhje në mënyrë të ndershme dhe me integritet, sipas Modelit 01 të Udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020;
- deklaratën për hapjen e llogarisë së posaçme nga kryetari i partisë, sipas Model 01/1 të Udhëzimit.

Pas verifikimeve përkatëse konstatohet se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia Kristian Demokrate është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 02, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjeshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vlorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, të ndryshuar

VENDOSI:

1. Të regjistrojë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, “Partia Kristian Demokrate”, me Kryetar z. Dhimitër Muslia, me shkronjat nistore “PKD”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

